



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR
SEKTORI I SHËRBIMEVE SHOQËRORE DHE STREHIMIT

Nr. 129 Prot

Maliq, më 12.01.2021

LËNDA: Për shpallje.

**NJËSISË ADMINISTRATIVE: MALIQ, POJAN, LIBONIK, PIRG, VRESHTAS, GORË,
MOGLICË.**

THIRRJE PËR APLIKIM

Në zbatim të ligjit 22/2018 "Për Strehimin Social" Neni 23, Bashkia Maliq fton të gjithë subjektet publike dhe private, që janë të interesuar të investojnë në banesa sociale me qira ose që disponojnë banesa për t'i dhënë me qira (për familjet në nevojë për strehim), të aplikojnë pranë Sektorit të shërbimeve Shoqërore dhe Strehimit për të përfituar **statusin e pronarit social**.

Kushtet për të përfituar statusin e pronarit social:

Subjekti publik apo privat ka në pronësi një banesë, me dokumentacion të rregullt ligjor, nuk ka konflikte pronësie, është i gatshëm t'a japë me qira për familjet e pastreha.

Subjektit publik ose privat i jepet statusi "pronar social" kur:

- banesa e tij plotëson kushtet teknike dhe normat e strehimit në fuqi, referuar raportit të strukturës së njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- qiraja me të cilën ofrohet banesa me qira nuk është më e lartë sesa qiraja mesatare në tregun e lirë;
- nënshkruan një kontratë me njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku bien dakord për mënyrën e menaxhimit të banesës së tij;
- nënshkruan deklaratën se nuk do të refuzojë qiramarrësin për arsye që përbëjnë diskriminim.

Marrëveshja ndërmjet pronarit social dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore

Pronari social dhe njësia e vetëqeverisjes vendore nënshkruajnë një marrëveshje. Kjo marrëveshje parashikon:

- afatin e marrëveshjes, që nuk mund të jetë më pak se 3 vjet;
- masën e qirasë mujore dhe mënyrën e shlyerjes së saj;
- mënyrën e administrimit të pronës dhe të marrëdhënieve me qiramarrësin.

Mbështetja e pronarit social

Pronari social mbështetet nëpërmjet financimeve për subvencionin e qirasë, për familjet përfituese që janë pa të ardhura.

Pjesë e marrëveshjes do të jetë edhe dakordësia për lehtësirat fiskale që do ti propozohen Këshillit Bashkiak, sipas hapësirave ligjore.

Për çdo informacion mund të paraqiteni pranë sportelit të Drejtorisë së Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, bashkia Maliq, apo në email: ledionm@yahoo.it

Nr. 05 Prot
Data: 12.01.2021

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

